

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-224/13

**Prishtinë,
12 mars 2014**

Në çështjen juridike të

M S

P 4

8 P

M Z

Pala ankuese

Kundër

Nuk dihet

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17530), të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 12 mars 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

Hedhet poshtë si e pa-afatshme ankesa e M S kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17530) të datës 6 qershor 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 3 nëntor 2006, M S ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronëso (KPA), duke kërkuar pronësinë dhe ri-posedimin e ngastrave nr. 51/1, 113,130/1 dhe 137 in Druar të Vushtrrisë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 153,12 ari, fleta poseduese nr. 17, e lëshuar nga Zyra për Kadastër dhe Pronë të Paluajtshme më 6 korrik 1994. S e kishte paraqitur kërkesën në emër të babait të saj të ndjerë, P S. Në kërkesë, M S ka deklaruar se data e humbjes ishte 6 qershor 1999.
2. AKP-ja e ka regjistruar A B si palë përgjegjëse në kërkesë.
3. Një kërkesë tjetër ishte paraqitur në AKP nga Lubica Saranović, e cila kërkesën e kishte paraqitur në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë, B Spër të cilin pretendohet ta ketë fituar pronësinë nga nëna e tij e ndjerë, M S. M S dhe B S ishin vëlla e motër.
4. Me vendimin grupor KPCC/D/A/155/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA07492) të datës 6 qershor 2012, KKPK-ja ka vendosur se B S është pronar i “pronës së kërkuar”, e cila ishte identifikuar si ngastra nr. 51/1.
5. Po në të njëjtën ditë, më 6 qershor 2012, me vendimin grupor KPCC/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 17530), KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga Milica Stojisavljević. Në paragrafin 144 deri te 148 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit grupor të datës 25 janar 2013 i referohet në mënyrë specifike kësaj kërkesë, theksohet se P S asnjëherë nuk e kishte fituar pronësinë ndaj pronave të kërkuar dhe se M S nuk kishte arritur që të vërtetojë

pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore ndaj pronave të kërkuara. Në vendimin e vërtetuar të datës 25 janar 2013, nuk është cekur asnjë palë përgjegjëse në kërkesë.

6. Vendimi i ishte dorëzuar Milica Stojisavljević më 11 mars 2013. Ajo ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së KPCC/D/A/156/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17530) më 26 korrik 2013. Ankesa nuk i është dorëzuar ndonjë palë përgjegjëse në ankesë apo ndonjë palë të interesuar. Gjykata Supreme e ka pranuar lëndën më 5 shkurt 2014.

Pretendimet e palës ankuese

7. Milica Stojisavljević pretendon se vendimi i KKPK-së është i gabuar sepse vëllai i saj B S nuk është bartës i së drejtës pronësore. Prona është regjistruar në emër të babait të saj të ndjerë, P S dhe se procedura e trashëgimisë nuk ka përfunduar ende.
8. M S nuk ka sqaruar se përse ankesa nuk ishte paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve.

Arsyetim ligjor

9. Ankesa është e papranueshme. Ajo nuk është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e pa-afatshme.
10. Në bazë të asaj që u cek më lartë e në përputhje me nenin 13.3, pikën (b) të ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

11. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva – Ermenkova, Gjyqtare, EULEX

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Urs Nufer, Gjyqtar, EULEX